

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Klinika Akili” Shpk

Ortakët themelues:

- 1. **Z.Vasil Llajo** i biri i Spiros ,lindur më datë 24/11/1956 në Sarandë dhe banues në Tiranë, me numër Karte Identiteti F61124009B.
- 2. **Z.Gert Peshkatari**, i biri i Pavllos, lindur më datë 16/10/1977 në Tiranë dhe banues në Tiranë me numër Karte Identiteti H71016123C.

Bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar), sot më datë 23.06.2022 hartojnë këtë Akt Themelimi të shoqërisë tregtare si më poshtë vijon;

NENI 1

Emri

1.1 Shoqëria tregtare mban emrin ***“Klinika Akili” Shpk.***

1.2 Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.

NENI 2

Forma

2.1 Shoqëria tregtare ***“Klinika Akili” Shpk***,ka formën e një **shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.**

NENI 3

Zyra Qendrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar ***“Klinika Akili” Shpk*** do të ketë zyrën e saj qendrore në adresën: Rruga Lord Bajron,Laprake,Tirane.

NENI 4

Objekti i Veprimtarisë

4.1 Veprimtaria tregtare e Shoqërise eshte:

(i) Klinikë Mjekesore, qe perfshin por pa u kufizuar ne sherbime ambulatorë, sherbime te analizave te ndryshme mjekesore dhe

(ii) Cdo aktivitet qe lidhet apo qe i sherben aktivitetit te Klinikës Mjekësore.

NENI 5

Kohëzgjatja

5.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë ***“Klinika Akili” Shpk*** do të jetë me afat të pacaktuar.

NENI 6

Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

6.1 Shoqëria tregtare ***“Klinika Akili” Shpk*** mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7

Përgjegjësia e Ortakëve

7.1 Ortakët nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë ***“Klinika Akili” Shpk*** dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

NENI 8

Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ***“Klinika Akili” Shpk*** është 1 000 (një mijë) lekë.

Ortakët e shoqërisë janë:

1- Z. **Vasil Llajo** është zotërues i 1 (një) kuote e cila përbën 50 % të kapitalit të shoqërisë.

2- Z. **Gert Peshkatari** është zotërues i 1 (një) kuote e cila përbën 50 % të kapitalit të shoqërisë.

NENI 9

Organet e Shoqërisë


Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 10

Administratori



Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Ortakë e Shoqërisë. Afati i emërimit është 3 (tre) vjet. Kompetencat e adminsitраторit përcaktohen në statutin e shoqërisë.

Administrator i Shoqërisë është Z. Denis Shkalla i biri Besnikut, i datëlindjes 28.12.1993, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i pasaportës me numër J31228090Q.

Ky Akt Themelimi përpilohet në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore.

ORTAKËT

E SHOQERISË ME PERGJEGJESI TË KUFIZUAR

“Klinika Akili” Shpk

Vasil LLAJO

Gert PESHKATARI

The image shows two handwritten signatures in blue ink. The signature on the left is for Vasil LLAJO and the one on the right is for Gert PESHKATARI. Both signatures are stylized and cursive.